



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 409 prot.

Tiranë, më 24.04.2026

NJOFTIM
PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT “TISH DAIJA”
Në 100-vjetorin e lindjes së Mjeshtrit të Madh të Muzikës

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ligjin nr.35, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, shpall konkursin “Tish Daija” - Në 100-vjetorin e lindjes së Mjeshtrit të Madh të Muzikës.

Kategoritë e krijimtarisë së kërkuar:

- 1. Krijim për vokal dhe piano ose vokal dhe formacion instrumentesh me zgjedhje të lirë për muzikë dhome dedikuar krijuesve të rinj:**
 - a) Soprano, Mezzo-soprano, Tenor, Bariton, Bas
(Jo më shumë se 5 minuta).
 - b) Formacione nga 2 deri në 5 instrumente me ose pa vokal
(Jo më shumë se 10 minuta)
- 2. Krijim për Kor a capella**
(4-8 minuta)
- 3. Krijim për Orkestër Harqesh**
(8-12 minuta)
- 4. Krijim për Orkestër Simfonike**
(10-15 minuta).

Formacioni i Orkestrës Simfonike të TKOBAP-së

- Flaut I
- Flaut II/Piccolo
- Oboe I
- Oboe II/Korno angleze
- Klarinetë I
- Klarinetë II
- Fagot I
- Fagot II
- Korno I
- Korno II
- Korno III
- Korno IV
- Trombë I
- Trombë II
- Trombon I
- Trombon II
- Trombon III/Trombon bas
- Timpan
- Perkusion
- Harpë
- Violinë I
- Violinë II
- Violë
- Violonçel
- Kontrabas

Përzgjedhja e fituesve:

Krijimet do të përzgjidhen nga një grup i përbërë nga personalitete të artit dhe muzikës duke përzgjedhur nga e gjithë krijimtaria e paraqitur në komision:

- **10 vepra krijime** për vokal dhe piano ose vokal dhe formacion instrumentesh me zgjedhje të lirë për muzikë dhome:
 - a) Soprano, Mezzo-soprano, Tenor, Bariton, Bas (5-10 minuta)
 - b) Formacione nga 2 deri në 5 instrumente me ose pa vokal (Jo më shumë se 10 min)
 - **10 vepra** për kor a cappella (4-8 minuta)
 - **6 vepra** për orkestër harqesh (8-12 minuta)

- **3 vepra** krijim për orkestër simfonike (10-15 minuta)

Kushtet e pjesëmarrjes:

1. Çdo krijues duhet të paraqesë maksimumi 1 (një) vepër për secilën kategori të krijimtarisë së kërkuar.
2. Çdo krijues mund të shpallet fitues me maksimumi 2 (dy) krijime nga të gjitha kategoritë e kërkuara.
3. Të gjitha krijimet duhet të jenë origjinale dhe të painterpretuara më parë.

6. Krijimi duhet të dorëzohet në formatet e mëposhtme:

- Partiturë e plotë digjitale full score (e notizuar në format elektronik)
 - Partitura solistike për çdo instrument të orkestrës
 - Partitura vokale për solist dhe kor (me tekstin në partiturë)
 - Version audio (MIDI/projekti për dëgjim)
 - File e partiturës nga programet Sibelius, Finale, Dorico etj.
 - Audio në formatin *mp3* për dëgjim
7. Çdo krijues i interesuar duhet të plotësojë pranë sekretarisë së TKOBAP-së formularin e regjistrimit për konkursin si dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës (CV-në artistike dhe fotokopje të një mjeti identifikimi) të cilat duhet t'i bashkëngjiten dosjes së aplikantit.

Përzgjedhja e fituesve

Krijimet do të përzgjidhen nga një grup i përbërë nga personalitete të artit dhe muzikës duke përzgjedhur veprat sipas kategorive.

Veprat e përzgjedhura do të interpretohen në një koncert premierë nga artistët në Festivalin “Netët e Muzikës Shqiptare”.

Të drejtat e autorit do të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Në rast se vepra/t muzikore kualifikohet/n apo shpallet/n fituese, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, ka të drejtën e plotë për përdorimin dhe vënien në skenë të veprës origjinale që do të ekzekutohet.

Për rregullimin e marrëdhënieve mbi të drejtën e autorit palët do të nënshkruajnë një marrëveshje (midis krijuesit të veprës dhe TKOBAP), për termat dhe rregullimin e mënyrës së përdorimit të veprës.

Afati i dorëzimit të materialeve është deri ditën e martë, datë 30 qershor 2026, ora 16:30, pranë sekretarisë së Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor ose në adresën e postës elektronike zyrtare sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Aulon Naçi

